

20240190546

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 25 paragrafi (2) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), ministri i Arsimit dhe Shkencës, miratoi

PROGRAMIN PËR TRAJNIME PËR PËRKRYERJE PROFESIONALE TË MËSIMDHËNËSVE PËR VITIN 2024

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për përkryerjen profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2024.

Neni 2

Trajnimet për përkryerje profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2024 janë nga këto fusha, nënfusha dhe temat e trajnimit:

I. PËR SHKOLLAT FILLORE

1. FUSHA: Njohuri për lëndën mësimore dhe sistemin edukativ-arsimor

Nënfusha: Njohuri për sistemin edukativ- arsimor

Temat:

- Mësimi në distancë: aplikacionet e internetit dhe platformat e të mësuarit,
- Edukimi në kontekstin bashkëkohor: zhvillimi i aftësive socio-emocionale të nxënësit,
- Multikulturalizmi në shkollat njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe,
- Vetëvlerësimi i cilësisë së procesit arsimor në nivel të shkollës dhe
- Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë.

2. FUSHA: Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Nënfusha: Planifikimi dhe përgatitja e mësimdhënies

Tema:

- Gjithëpërfshirja (inkluzioni) dhe qasjet në mësimdhënien e nxënësve me nevoja/aftësi të veçanta arsimore.

Nënfusha: Zbatimi i mësimdhënies

Temat:

- Aplikimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie,
- Mësimdhënia e bazuar në një qasje të bazuar në problem,
- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve,
- Mësimdhënie për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësit,
- Mësimdhënia që synon arritjen e rezultateve të nxënësve të një niveli më të lartë,
- Digjitalizimi në arsim,
- Arsimi gjithëpërfshirës,
- Vështirësitë specifike të nxënësve dhe
- Lexim me kuptim.

Nënfusha: Vlerësimi i nxënësve

Tema:

- Dizajnimi i testeve objektive të njohurive.

Nënfusha: Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

Tema:

- Zhvillimi profesional dhe këshillimi në karrierë i nxënësve (mentorimi, monitorimi, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.).

3. FUSHA: Krijimi i një mjedisi stimulues mësimor

Nënfusha: Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt dhe stimulues

Temat:

- Ballafaqimi me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe bulizmin kibernetik dhe

- Zgjidhja e konflikteve me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.

Nënfusha: Klima në shkollë

Tema:

- Strategjitë e menaxhimit të klasës - parime dhe shembuj të praktikës së mirë për krijimin e një atmosfere pozitive të punës në klasë dhe në klasën virtuale/ online.

4. FUSHA: Gjithëpërfshirja sociale dhe arsimore

Nënfusha: Gjithëpërfshirja (inkluzioni) sociale dhe arsimore

Tema:

- Strategjitë, metodat dhe teknikat për të punuar me nxënës të talentuar.

5. FUSHA: Zhvillimi profesional si dhe bashkëpunimi profesional

Nënfusha: Bashkëpunimi profesional

Tema:

- Bashkëpunimi profesional i mësimdhënësve (aktivet profesionale, bashkësitë e të nxënësve, mentorimi, etj.).

II. PËR SHKOLLAT E MESME

1. FUSHA: Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Nënfusha: Realizimi i mësimin

Tema:

- Aftësitë digjitale të mësimdhënësve në funksion të mësimdhënies (në monitorimin e nxënësve, në zgjidhjen e situatave problemore, në veprimtari kërkimore etj.).

Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 12-547/3

24.1.2024

Shkup

Ministër

i Arsimit dhe Shkencës,

Doc. dr **Jeton Shaqiri**, d.v.